



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

18366/164
Nr. prot.

Tiranë, më 6.3.2019

Lënda: Dërgohet Udhëzimi “Për një ndryshim në Udhëzimin plotësues ‘Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2019’”.

MINISTRIA/ INSTITUCIONI _____

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT

DEGA E THESARIT _____

Mbështetur në ligjin nr. 99/2018 “Për Buxhetin e vitit 2019” dhe në vijim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, bashkëlidhur ju përcjellim Udhëzimin nr. 111, datë 6.3.19 “Për një ndryshim në Udhëzimin plotësues nr.1, datë 17.01.2019, ‘Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2019’”.

MINISTËR

Anila Denaj





18366/13

6.3.2019

UDHËZIM PLOTËSUES

Nr. 1/1, datë 6.3.2019

“PËR

NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN PLOTËSUES NR. 1, DATË 17.01.2019 ‘PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2019’

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 22, të ligjit 99/2018, “Për Buxhetin e vitit 2019” dhe në vijim të Udhëzimit të ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, paragrafi 2,

UDHËZ O J :

1. Në Udhëzimin Plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2019”, në kreun I. “Procedura specifike shtesë për zbatimin e Buxhetit të Shtetit”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Pika 24, riformulohet si më poshtë:

“24. Në zbatim të VKM nr.673 date 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, AKSHI është institucioni i vetëm përgjegjës për kryerjen e procedurave të prokurimit, tenderimit dhe lidhjes së kontratës për të gjitha sistemet IT. Për këtë qëllim, deri në rishikimin e ligjit të buxhetit 2019, procedura që do të ndiqet është si vijon:

- a. Lidhja e të gjitha kontratave për blerjen e mallrave, dhe shërbimet për mirëmbajtjen e sistemeve IT (shpenzime kapitale dhe korente), kryhet nga AKSHI.
- b. **Për shpenzimet korrente**, kontrata për shërbimet e mirëmbajtjes lidhet në emër të titullarit të AKSH-it me përfitues të shërbimit AKSH-in, pasi fondet përkatëse për vitin 2019 për mirëmbajtjen e sistemeve të IT janë të miratuara në buxhetin e AKSH-it. Këto kontrata depozitohen nga ana e AKSH-it në degën e thesarit për t’u regjistruar në SIFQ.
- c. **Për shpenzimet kapitale**, kontrata lidhet në emër të titullarit të AKSHI-t, me përfitues të mallit, njësinë e qeverisjes qendrore e cila ka në përdorim sistemin IT përkatës, si edhe disponon fondet për këtë qëllim në buxhetin e saj të miratuar për vitin 2019.

- d. Kontrata e lidhur sipas pikës (c) më sipër, depozitohet në degën e thesarit përkatëse. duke u regjistruar në SIFQ për institucionin përfitues të cilit i është alokuar buxheti për blerjen e mallit të cilësuar në kontratën respektive, miratuar për vitin 2019. Gjithashtu, edhe pagesat kryhen për llogari të njësisë së qeverisjes qendrore përfituese, duke marrë konfirmimin paraprak nga AKSHI.
- e. Pas rishikimit të ligjit të buxhetit 2019 të gjitha kontratat sipas pikës (d), të regjistruara për institucionin përfitues, do të anulohen dhe do të ri-regjistrohen në SIFQ në emër të AKSHI-t. të cilit do t'i çelen edhe fondet e nevojshme sipas ligjit të rishikuar të buxhetit 2019.
2. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet e tij përfundojnë më 31 Dhjetor 2019.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

